



# USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 43 (827741)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 22 Tetor 2021

## Stërvitja "Flotex-21"



### Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj: Kapacitetet e Forcës Detare janë një aset i rëndësishëm i FA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, zhvilloi një vizitë inspektuese të stërvitjes "Flotex-21", faza e ekzekutimit të së cilës po zhvillohet në Gjirin e Vlorës në periudhën 18-22 tetor 2021. Stërvitja

Flotex është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe çertifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore. E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë...

» faqe 2

## Gjenerallejtënant Fernando De La Cruz Caravaca, vizitë zyrtare në Shqipëri "Do të vijojmë kryerjen me përkushtim të misionit, për të qenë në lartësinë e sfidave me të cilat përballet NATO"

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i SHPFA gjeneralmajor Begaj presin komandantin e Qendrës së Bashkuar Operacionale Ajrore të NATO-s

» faqe 3



## Njësi mamografie edhe për vajzat e gratë e FA

Tetori rozë, zëvendësministria e Mbrojtjes: Mos hezitoni, pa gruan nuk ka jetë!



» faqe 5

## Komunikimi tokë-ajër-tokë

Peleshi: Të mësojmë sa më shumë nga ky trajnim dhe të jemi të aftë ta mirëmbajmë

Efektivët e Forcës Ajrore trajnim për sistemin e komunikimit tokë - ajër - tokë, Peleshi: Të mësojmë sa më shumë nga ky trajnim dhe të jemi të aftë ta mirëmbajmë, ta update sa herë të jetë e nevojshme, ta bëjmë upgrade kur të vijë koha me burimet tona. Sistemi i radio komunikimit tokë - ajër - tokë ka mbledhur në një trajnim 4 - javor personelin ndërlidhës të Komandës së Forcës Ajrore. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, teksa përshëndeti efektivët në...



» faqe 4

## Forcat Speciale ky aset kombëtar

Heronjtë e heshtur për të cilët flet vetë historia

Batalioni i Forcave Speciale është krijuar me Burdhër të Këshillit të Mbrojtjes Nr.2, datë 16 tetor 1998, ndërsa aktiviteti i shtabit të këtij reparti ka filluar në shkurt 1999 me katër Grupe Speciale. Batalioni i Forcave Speciale është njësi me speciale e FA shqiptare me qëllim realizimin e detyrave më të komplikuara, më të vështira dhe më të rrezikshme që mund t'i ngarkohen një njësie operacionale, ku përfshihen operacione speciale...

» faqe 10-11



### Forumi To Be Safe (2BS)

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Bashkëpunimi i ngushtë do të na mbajë të sigurt

» faqe 8

### INTERVISTË ME ILIR KËLLEZI

Maratonomaku korçar fituesi i disa medaljeve

» faqe 7

### BETIMI USHTARAK

Akti moral dhe ligjor, që bashkon kombet nën një gjuhë

» faqe 14

# Stërvitja “Flotex-21”

## Gjeneralmajor prof.asoc. Bajram Begaj: Kapacitetet e Forcës Detare janë një aset i rëndësishëm i Forcave të Armatosura

*Stërvitja Flotex është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore*

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, zhvilloi një vizitë inspektuese të stërvitjes “Flotex-21”, faza e ekzekutimit të së cilës po zhvillohet në Gjirin e Vlorës në periudhën 18-22 tetor 2021. Stërvitja Flotex është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore. E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Në prezantimin e stërvitjes, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Sabri Gjinollari, njohu shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA me qëllimin, objektivat dhe skenarin e stërvitjes. Qëllimi i stërvitjes është rritja e ndërveprueshmërisë midis mjeteve detare dhe Grupit të Bordingut të Flotiljes Detare, si dhe testimi i procedurave të zbatimit të ligjshmërisë detare për operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtimit (SAR). Gjeneralmajor Begaj vlerësoi përkushtimin e treguar nga efektivat pjesëmarrës në stërvitje duke theksuar faktin se kapacitetet e Forcës Detare janë një aset i rëndësishëm i Forcave të Armatosura dhe kontributi i tyre në realizimin e misionit kushtetues të Forcës Detare dhe atë ligjor të Rojes Bregdetare, është jetik në sigurinë e vendit



Bashkëpunimi midis dy vendeve dhe angazhimet e mëtejshme që do kenë në të ardhmen

## “USNS Trenton”, Anija e Forcës Detare amerikane, vizitë në Portin e Durrësit

“USNS Trenton” Anija e Forcave Detare Amerikane e cila përdoret nga Marina Amerikane për transport pajisjesh, ka zhvilluar një vizitë portuale në portin e Durrësit, nga data 15-19 tetor 2021.

Komandanti i Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, vizitoi anijen amerikane “USNS Trenton” dhe u prit nga kapiteni i anijes Douglas Casavant si edhe kapiteni i rangut të dytë Tommy Seifert, komandanti i anijes amerikane “USNS Trenton”.

Gjatë takimit kapiteni Douglas Casavant u shpreh se “është kënaqësi të mirëpresim komandantin e Forcës Detare shqiptare duke vlerësuar bashkëpunimin midis dy vendeve dhe angazhimet e mëtejshme që do kenë në të ardhmen”.

Gjithashtu komandanti anijes Amerikane “USNS Trenton” kapiteni i rangut të dytë Tommy Seifert, zhvilloi një takim me komandantin e Forcës Detare gjeneral brigade Ilir Xhebexhia në komandën e Forcës Detare.

Gjithashtu edhe gjeneral brigade

Ilir Xhebexhia i shprehu mirënjohje dhe falenderime për bashkëpunimet e suksesshme të dyanshme që do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Ekuipazhi i anijes “USNS Trenton”, të shoqëruar nga koordinatore të Forcës Detare, zhvilluan vizita në qytetet historike të Krujës dhe Durrësit duke i njohur me objekte muzeale, historike dhe turistike.



STAFI

**ANJEZA MUSOLLARI**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**  
Hajrie **DEDAJ**

**Redaktore/ korrektore:**  
Suela **HODA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”



**M**inistri i Mbrojtjes Niko Peleshi i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, priti në një takim komandantin e Qendrës së Bashkuar Operacionale Ajrore të NATO, gjenerallejtënant Fernando De La Cruz Caravaca, i cili po zhvillon një vizitë zyrtare në Shqipëri.

Ministri Peleshi falënderoi gjeneral Caravaca për punën që ai dhe stafi i tij bëjnë për vëzhgimin dhe policimin e hapësirës ajrore të NATO-s dhe në veçanti, falënderoi fqinjët tanë, Italinë dhe Greqinë për kontributin e dhënë për policimin e hapësirës ajrore të vendit tonë.

Ministri i Mbrojtjes e njohu gjeneral Caravaca mbi ecurinë e projektit të Bazës Ajrore Kuçovë, si dhe projektet e tjera të modernizimit, sidomos ato që kanë të bëjnë me Forcën Ajrore, me fokus të veçantë në funksionimin e Radarit të Midës.

Nga ana e tij, gjeneral Caravaca e siguroi ministrin Peleshi se personeli i Qendrës së Bashkuar Operacionale Ajrore të NATO-s do të vijojë kryerjen me përkushtim të misionit, për të qenë në lartësinë e sfidave me të cilat përballet NATO. Gjithashtu, gjeneral Caravaca shprehu gatishmërinë të mirëpresë angazhimin e vendit tonë, që nëpërmjet Radarit të Midës, të kontribuojë në krijimin sa më të plotë të pamjes së përbashkët të hapësirës ajrore të Aleancës.

Gjenerallejtënant Fernando De La Cruz Caravaca, vizitë zyrtare në Shqipëri

# Gjeneral Caravaca: Do të vijojmë kryerjen me përkushtim të misionit, për të qenë në lartësinë e sfidave me të cilat përballet NATO

*Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i SHPFA gjeneralmajor Begaj presin komandantin e Qendrës së Bashkuar Operacionale Ajrore të NATO-s*



GJENERALLEJTËNANT FERNANDO DE LA CRUZ, KOMANDANTI I QENDRËS SHUMËKOMBËSHE PËR OPERACIONET AJRORE TË NATO-S, VIZITË NË FOCËN AJRORE SHQIPTARE,

## La Cruz: Ky takim, është një mundësi shumë e mirë për të diskutuar konkretisht se për çfarë kanë nevojë Forcat Ajrore

*Komandanti i Qendrës Shumëkombëshe për Operacionet Ajrore të NATO u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj*

**M**bas takimit me ministrin e Mbrojtjes dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura shqiptare, komandanti i Qendrës Shumëkombëshe për Operacionet Ajrore të NATO (CAOC), Torrejon, Spanjë, gjenerallejtënant Fernando De La Cruz u prit me ceremoni nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore shqiptare, kolonel Ylli Pulaj dhe stafi në mjediset e Komandës së Forcës Ajrore.

Në takim, kolonel Pulaj pasi i uroi mirëseardhjen, njohu komandantin e CAOC me projektet e kapacitetet që Forca Ajrore ka në zhvillim si dhe integrimin e tyre me sistemet, procedurat, programet e standardet e NATO, si edhe diskutoi mbi bashkëpunimin e mbështetjen nga Komanda e CAOC, kryesisht për Qendrën e Kontroll-Raportimit me të gjithë gamën e ndërveprueshmërisë gjatë operacioneve shumëllojshme ajrore.

Gjenerallejtënant Fernando De La Cruz shprehu kënaqësinë për këtë vizitë në Komandën e Forcës Ajrore, pasi ky takim, është një mundësi shumë e mirë për të diskutuar konkretisht se për çfarë keni nevojë, me qëllim mbështetjen e Forcës Ajrore. Bashkëpunim do të fokusohet jo vetëm me shkëmbim vizitash por edhe përvoja duke mundësuar poste të ndërsjellta pune të ekspertëve të fushës me qëllim njohjen e punës dhe

unifikimin e procedurave standarte, të domosdoshme të përditshmërisë, të cilat janë përfituese dhe me vlerë, veçanërisht për më të rinjtë, të cilët aftësohen për të operuar në çdo operacion real ajror.

Kolonel Pulaj dhe shefi i Shtabit i Forcës Ajrore, kolonel Arben Cenolli diskutuan fushat konkrete që Komanda e CAOC mund të mbështesë, duke përfshirë edhe trajnimin e personelit.

Më pas, komandanti i CAOC zhvilloi një vizitë në Qendrën e Kontroll-Raportimit, për të cilin, zëvendëskomandanti i kësaj qendre, nënkolonel Myslim Rrasa mbajti një prezantim njohës mbi misionin, detyrat, progresin dhe pritshmëritë për të arritur nivelin e plotë operacional të Qendrës së Kontroll-Raportimit (QKR).

Gjithashtu gjeneral De La Cruz pati një takim me kursantët, ushtarakë të QKR dhe instruktorët e palës italiane, të cilët e informuan komandantin e CAOC mbi ecurinë e konsoliduar të kursit Bazë të Vëzhgimit Ajror.

Në fund të takimeve, kolonel Ylli Pulaj dhe gjenerallejtënant Fernando De La Cruz u shprehën besimplotë në bashkëpunimin e ndërsjellë të frytshëm në të ardhmen duke shkëmbyer kështu edhe dhuratat zyrtare të kësaj vizite.





Efektivët e Forcës Ajrore trajnim për sistemin e komunikimit tokë - ajër - tokë

# Peleshi: Të mësojmë sa më shumë nga ky trajnim dhe të jemi të aftë ta mirëmbajmë

**E**fektivët e Forcës Ajrore trajnim për sistemin e komunikimit tokë - ajër - tokë, Peleshi: Të mësojmë sa më shumë nga ky trajnim dhe të jemi të aftë ta mirëmbajmë, ta update sa herë të jetë e nevojshme, ta bëjmë upgrade kur të vijë koha me burimet tona.

Sistemi i radio komunikimit tokë - ajër - tokë ka mbledhur në një trajnim 4 - javor personelin ndërlidhës të Komandës së Forcës Ajrore. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, teksa përshëndeti efektivët në Bazën Ajrore të Farkës, kërkoi prej tyre të mësojnë sa më shumë nga ky trajnim, pasi është shumë i rëndësishëm për të ardhmen, për ta mbajtur gjatë gjithë kohës në funksion sistemin.

“Unë vetëm një kërkesë kam që, pasi të konfigurohet ky sistemi i komunikimit tokë - ajër - tokë, të jetë 100% efektiv, siç e kemi planin, në dhjetor. Të mësojmë sa më shumë nga ky trajnim dhe të jemi të aftë ta mirëmbajmë, ta update sa herë të jetë e nevojshme, ta bëjmë upgrade kur të vijë koha me burimet tona, jo të presim gjithmonë kontraktin”.

Në fjalën e tij ministri Peleshi tha, se një sistem i tillë është i nevojshëm, veçanërisht në kohë emergjencash civile, në përmbajtje, gjatë periudhës së verës, kur ka vatra zjarri, ndaj vuri theksin te ndërtimi i kapaciteteve të brendshme.

Ky sistem komunikimi tokë - ajër - tokë synon mbulimin mbarëkombëtar në lartësinë 150 m mbi lartësinë e tokës, të 95% të territorit.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe komandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj).



## Në Qendrën Stërvitore Pashaliman ka përfunduar kursi SAR dhe Bording

**N**ë Qendrën Stërvitore Pashaliman ka përfunduar kursi SAR dhe Bording, i cili u zhvillua në një periudhë dy javore dhe morën pjesë pesë kursantë. Pjesa e trajnimit u realizua në dy faza teorike mbi njohurit e SAR dhe Bording gërshetuar këto në veprime praktike, të cilat u zhvilluan dhe në det sipas detyrave që kryen ekipazhi i anijeve të Forcës Detare. Kursantët gjatë kësaj periudhe kanë treguar disiplinë të lartë dhe korrektësi në zbatimin e rregulloreve bazë të Forcave të Armatosura. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare, Pashaliman krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të këtij kursi të rëndësishëm.





## Njësi mamografie edhe për vajzat e gratë e FA

# Tetori rozë, zëvendësministria e Mbrojtjes: Mos hezitoni, pa gruan nuk ka jetë!

**D**rejtoje Timonin nga Shëndeti Yt! Tetori Rozë si muaji i ndërgjegjësimit global për të rritur ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit. Vetëkontrolli mujor dhe ekzaminimi nga personeli shëndetësor janë mënyrat e kontrollit më efektive që ndihmojnë në diagnostikimin në kohë të kancerit të gjirit!

Edukimi dhe informimi për shenjat dhe simptomat që lidhen me kancerin e gjirit janë kryesore gjatë këtij muaji.

Tetori, në të gjithë botën është muaji i ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Një sëmundje e cila sipas të dhënave nga OBSH shkakton rreth 680.000 vdekje gjatë një viti në rang global. Ky lloj kanceri është një nga llojet më të shpeshta të tumoreve tek gratë, kryesisht tek ato të moshës mbi 35 vjeç.

Për nga prekshmëria dhe vdekshmëria, renditet në vendin e parë në sëmundshmërinë e popullsisë femërore në tërë botën e industrializuar. Kontinenti amerikanorior (SHBA dhe Kanada) rezultojnë të ketë prekshmërinë më të lartë, zbulohen çdo vit 90 raste në 100.000 gra. Në Europë dhe në Australi të dhënat tregojnë për një përhapje paksa më të ulët. Në vendet e BE, çdo vit preken 300.000 gra nga kjo sëmundje. Afrika Qendrore, Amerika Latine dhe Europa Lindore kanë parametra shumë më të ulët, pothuajse të përgjysmuar në krahasim me Perëndimin, ndërsa në Japonim kanceri i gjirit është fare pak i përhapur. Në përgjithësi në Azi e në Afrikë është shumë më pak i përhapur se sa në Perëndim.

Sipas kërkuesve shkencorë në këtë fushë, këto diferenca kanë të bëjnë jo vetëm me pozicionin gjeografik dhe shkallën e zhvillimit industrial, por parasëgjithash me stilin e të jetuarit, mjedisin dhe ushqimin.

Studimet tregojnë se familjariteti me këtë lloj kanceri rrit rrezikun, por kjo nuk do të thotë se sëmundja është gjenetike dhe trashëgueshme në të gjitha rastet. Konsiderohet i trashëgueshëm vetëm kur kanceri i gjirit shpreh dy onkogjene, BRA 1 dhe BRA 2 të cilët gjenden respektivisht në kromozomën 3 dhe në kromozomën 17, por këto rastë përbejnë një përqindje të vogël (5-10 %) të të gjitha neoplazive të gjirit.

Në Shqipëri kanceri i gjirit është mjaft i përhapur, rreth 650 raste të

rinj çdo vit, shifër e lartë për popullsinë femërore të moshës mbi 30 vjeç të vendit.

Për të sensibilizuar gratë dhe vajzat në uniformë, pranë Garnizonit "Skënderbej", është vendosur një njësi e lëvizshme mamografie për kontrollin e tyre.

Zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici shoqëruar edhe nga zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu ishin të pranishme në këtë pikë, ku çdo ditë vijon kryerja e ekzaminimeve.

Zëvendësministria Bici iu drejtua me një mesazh të gjitha vajzave



dhe grave të FA: "Mesazhi im sot nuk vjen si zëvendësministre, por mbi të gjitha si grua dhe këtë mesazh sensibilizues e kam përtej grave në uniformë! Ky mesazh është për çdo grua, nënë, motër apo bashkëshorte! E vetmja mënyrë që kemi për të shpëtuar veten është zbulimi i hershëm! Mos hezitoni në asnjë moment të bëni kontrollin! Pa gruan nuk ka jetë!", - u shpreh zëvendësministria Dallëndyshe Bici.

Znj. Bici tha se kjo sëmundje e tmerrshme nuk ka kursyer as gratë në uniformë, ndaj Ministria e Mbrojtjes, së bashku me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ka ndërmarrë këtë aktivitet, i cili do të vazhdojë përgjatë gjithë tetorit dhe jo vetëm.

## Qendra e Personel Rekrutimit

## Një hap i sigurt drejt suksesit

*Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit me aleatin tonë strategjik SHBA, ofron kuota studimi për studentët tanë*

**M**inistria e Mbrojtjes së Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit me aleatin tonë strategjik SHBA, ofron kuota studimi për studentët tane. Një hap i sigurt drejt suksesit.

Mundësi studimi në Akademitë Ushtarake më të mira të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

18 kuota studimesh gjithsej;  
- 6 kuota studimi në Akademinë e Forcave Ajrore  
- 6 kuota studimi Akademinë e Forcave Detare  
- 6 kuota studimi në Akademinë Ushtarake West Point  
Dokumentat pranohen deri më 15 Nëntor 2021.

Qendra e Personel Rekrutimit kërkon të përzgjedhë 6 (gjashtë) kandidatë për çdo Akademi Ushtarake (Akademinë e Forcave Ajrore, Akademinë e Forcave Detare dhe Akademinë West Point) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për vitet akademike 2022-2026. Kandidatët e përzgjedhur do të jenë pjesë e seleksionimit të mëtejshëm nga vendi pritës.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 15 nëntor 2021.

#### 1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë i dënuar nga gjykata për vepra penale.
- Të mos jetë në ndjekje penale
- Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata.
- Të mos ketë probleme me deportimin.
- Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera.
- Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale.
- Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik (1 shtator 2022).
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 për femrat.
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet e vitit të fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para dhe në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave.
- Të ketë notën mesatare të arsimit parauniversitar, jo më pak se 7 (shtatë).
- Të mos jetë i martuar.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht



të Transmetueshme), të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike.

- Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohet nga vendi pritës në Shqipëri ose pranë akademive ushtarake jashtë vendit.

- Të zotërojnë gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar e të folur dhe të sigurojnë mbi 75 pikë në testimin ALCPT. Ata duhet të jenë regjistruar për zhvillimin e testeve online të TOEFL dhe SAT ose ACT.


- Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhsore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim



pranimin në shkolla ushtarake.

- Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit.
- Të plotësojë kushtin e sigurisë.
- Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake.
- Kandidatët nuk mund të regjistro-

hen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: a. Kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit. b. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato.



- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

#### 2. Dokumentet për regjistrim:

• Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pritjes të Qendrës së Personel Rekrutimit, Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim për ndjekjen e studimeve ushtarake, ku të specifikohet institucioni arsimor dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave, ose vërtetim që ka mbaruar dy vitet e para të arsimit me listën e notave.

□ Fotokopje e kartës së identitetit. • Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë.

• Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit.

• Certifikatë për TOEFL, SAT (ACT), ose dokument i cili vërteton se aplikanti është regjistruar për testimet që zhvillohen online për TOEFL dhe SAT ose ACT.

• Raport mjekësor i aftë për të kryerjen e studimeve, të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit të kandidatit, i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohej se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike.

• Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorët e certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes Sociale..

• Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 10 ditëve:

- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata.
- Vërtetim nga prokuroria.
- Vërtetim nga përmbartimi.
- Raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake.

#### 3. Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj

(Anglisht): 17.11.2021

Testi Fizik: 17.11.2021

Testi Intelektual: 18.11.2021

Testi Psikologjik: 18.11.2021

MBI 100 EFEKTIVË NË MARATONËN E TIRANËS, 3 FITUES

## Peleshi: Lëvizja sportive brenda FA, së shpejti me një program të ri entuziast

Forcat e Armatosura të Shqipërisë iu bashkuan “Maratonës së Tiranës 2021” me një ekip prej më shumë se 100 efektivësh. Pjesëmarrësit mbuluan të gjitha disiplinat e garave, duke marrë pjesë në 10 km, 21 km dhe 42 km.

Efektivët e FA u dalluan për sakrificën dhe shpirtin e lartë të garës duke zënë edhe vende nderi: Ilir Këllezi i Qendrës Sportive të FA fitoi vendin e parë në garën 42 km për meshkuj, tetare Luiza Gega fitoi vendin e dytë po në këtë garë, për femra. Ndërsa në garat 10

km vendi i dytë u fitua nga major Bledar Mesi i AFA.

Ky rezultat u përshëndet edhe nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili u shpreh: “Lëvizja sportive brenda Forcave të Armatosura, së shpejti me një program të ri entuziast. Krenar për shpirtin kampion të FA!”

Në Maratonën e Tiranës morën pjesë rreth 2500 garues, prej të cilëve 1000 vinin nga shtete të tjera të botës. Gara u zhvillua në 4 kategori të ndryshme, për të cilat pati nga tre fitues.



## Intervistë me Ilir Këllezi triumfuesin e “Maratonës së Tiranës 2021”

# Maratonomaku korçar fituesi i disa medaljeve

*Maratona u mbajt në datë 17 tetor ku morën pjesë 2500 vrapues shqiptarë dhe të huaj*

**E**dhe një herë tjetër qyteti i Korçës tregoi se lind dhe rrit njerëz që e duan artin, të bukurën apo sportin. Një qytet që personifikon bukurinë dhe krenarinë shqiptare, përkatësisht djepin e trashëgimisë sonë kulturore. Një qytet i cili mbart zanafillën e dijes, shkollës së parë shqipe “Mësonjëtores”, por që ka treguar se ka dhe njerëz që e duan sportin dhe i janë përkushtuar atij, bëhet fjalë për atletin Ilir Këllezi pjesëmarrës në Maratonën e Tiranës i cili u shpall fitues në 42 kilometra. Maratona u mbajt në datë 17 tetor ku morën pjesë 2500 vrapues shqiptarë dhe të huaj vendin e parë për meshkuj e fitoi Këllezi, të dytin maqedonasi Igor Jakimovski, kurse për kategorinë e femra atletja ukrainase, Valentina Veretska dhe në vend të dytë atletja shqiptare Luiza Gega. Ilir Këllezi, pjesë e QKMBMFA-së në sektorin e sporteve dhe aktiviteteve në Ministrinë e Mbrojtjes. Merret me sport prej 18 vitesh ka qenë pjesëmarrës në disa gara jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj si: Lojërat Olimpike Evropiane në Baku, Ajzerbaxhan 2016 Lojërat Olimpike Mesdhetare në Mersin, Turqi 2012 dhe në Lojërat Olimpike Universale në Shenzhen, Kinë 2011. Gjithashtu në vitin 2019 ka marrë pjesë në garën që u zhvillua në Greqi, në qytetin e Janinës ku u rendit i pari në 600 garues. Mësonjëtorja është duke u përgatitur për sfidën e radhës Kampionatin Evropian të Krosit në Dublin të Irlandës. Për më shumë detaje të jetës si atlet dhe kontributin e tij në atletikën shqiptare realizuam një intervistë...

**Si i kujtoni fillimit tuaj si vrapues?**

Isha shumë i ri kur fillova të merresha me sportin e atletikës rreth moshës 14 vjeçare. Si fillim organizoheshin aktivitete sportive midis shkollave dhe ndër të ishte dhe atletika. Fill pas fitoreve që merrja nëpër shkolla u motivova më shumë dhe vendosa të



vazhdoja edhe më tej.

**Çfarë ju shtyn të merreni me këtë sport, me atletikën?**

Atletika është një sport i bukur, garë individuale që edhe stimujt i fiton në mënyrë individuale, kjo më shtyn të kërkojë edhe më shumë nga vetja.

**Prej 18 vitesh ju merreni me sport si do ta këshillonit dikë i cili dëshiron t'i bashkohet atletikës, që dhe ai si ju të zotërojë me sukses edhe distancat më të mëdha?**

Kam një kohë të gjatë që merrem me stërvitje, punë e palodhur, me kërkesa të shumta ndaj vetes. Njeriu zotëron shumë energji të panjohura brenda tij. Dëshira dhe vullneti për të përballuar ngarkesat e mëdha fizike gjatë stërvitjes janë çelësi kryesor i motivimit dhe i realizimit të objektivave.

**Ju arritët që të fitonit “Maratonën e Tiranës 2021” 42 kilometra sa e rëndësishme ishte kjo fitore në këtë moment të karrierës suaj? Si e**

**përjetuat?**

Që në fillimet e karrierës sime unë i kam vendosur objektiv vetes “të arrij gjithmonë majat” dhe rezultatet e mëparshme më motivuan të stërvitem rregullisht, intensivisht për çdo kompeticion. Bashkë me trajnerin tim mundohemi që të bëjmë më të mirën e mundshme për të arritur rezultat. Unë personalisht stërvitjen e konsideroj si garë me konkurrencë të fortë. U ndjeva shumë i lumtur, pasi ishte gara më e rëndësishme e maratonës, por dhe më i përgjegjshëm, pasi ishte edhe më e vështirë si garë.

**Çfarë e bënë të veçantë pjesëmarrjen në një garë si “Maratonë e Tiranës 2021”, e cila u zhvillua për të pestin vit?**

Ishte një aktivitet ndryshe nga vitet e tjera, sepse pikërisht këtë vit u realizua maratona e plotë e Tiranës dhe u certifikua nga Federata Botërore e Atletikës. Gjithashtu organizimi ishte më i

realizuar nga vitet e tjera kishte atletë nga 35 shtete të botës rreth 2500 garues që përfaqësonin ajkën e atletikës.

**I dyti në maratonë u rendit Igor Jakimovski nga Maqedonia e Veriut si ishte gara mes jush?**

Aktualisht me Igorin jemi miq të mirë prej kohësh, por edhe rivalë njëkohësisht. E vlerësoj për shpirtin e garës që jep në çdo aktivitet dhe e quaj një kundërshtar të denjë. Për sa i përket maratonës së Tiranës me Igorin kishim të njëjtin ritëm, në kalimin e kilometrave Igori mbeti disa minuta pas. Në malore pata një shikëputje dhe më pas vazhdoja me të njëjtin ritëm.

**Cilën nga pjesëmarrjet tuaja në gara, apo aktivitete do ta quanit suksesin tuaj më të madh?**

Në fakt janë disa medalje që dua të veçojë, e para në Jerevan të Armenisë në të cilën jam renditur i dyti në 5200 garues në vitin 2016. Në vitin 2017 mora pjesë në maratonën e Selanikut ku ishim 3000 garues atje u rendita i treti. Kurse në vitin 2019 mora pjesë në garën që u zhvillua në Greqi, por këtë herë në Janinë ku u rendita i pari në 600 garues.

**Gjatë garës emocionet janë të forta, sidomos kur jeni shumë pranë finishit, cili është në të vërtetë momenti juaj i preferuar dhe pse?**

Të jem i singërt që kur nisem në momentin e fillimit të garës shikëputja nga garuesit e tjerë më jep më shumë motivim të vazhdoj garën me ritme më të larta dhe të arrij sa më shpejt drejt finishit, sepse me shpërblehet i gjithë



Suksesin më të madh e kam arritur në disa aktivitete si: Lojërat Olimpike Evropiane në Baku Ajzerbaxhan 2016. Lojërat Olimpike Mesdhetare në Mersin, Turqi 2012 dhe në Lojërat Olimpike Universale në Shenzhen Kinë 2011.

**Medalja më e rëndësishme për ju në cilën maratonë është fituar?**

mundi dhe koha e investuar.

**Në karrierën tuaj numëroni disa medalje, por shpirtin e një atleti e mbajnë gjallë sfidat e vazhdueshme, cila është sfida juaj e radhës?**

Sfida ime e radhës është Kampionati Evropian i Krosit në Dublin të Irlandës, në dhjetor.

**Intervistoi: Hajrie Dedaj**

## FORUMI TO BE SAFE (2BS)

# Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Bashkëpunimi i ngushtë do të na mbajë të sigurt

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Në Forumin virtual To Be Safe (2BS) të organizuar nga Këshilli Atlantik i Malit të Zi, (15 tetor 2021), Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană, vlerësoi kontributet e vlefshme që Mali i Zi po jep për Aleancën, por dhe për sigurinë dhe stabilitet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Paqja dhe stabiliteti i qëndrueshëm në këtë rajon kërkojnë përpjekjen tonë të vazhdueshme kolektive”, tha z. Geoană, “politikat tona në rajon, përfshirë politikën tonë të Dyerve të Hapura, ndihmojnë në forcimin e stabilitetit dhe ndërtimin e bashkëpunimit më të madh në Ballkanin Perëndimor”.

Duke reflektuar mbi sfidat e sigurisë së sotme dhe të nesërme, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë e partneriteteve globale dhe bashkëpunimin e ngushtë me partnerët me mendje të njëjtë. “Sa më shumë të bashkëpunojmë, aq më shumë shans kemi për të mbrojtur stilin tonë demokratik të jetesës kundër atyre që përpigjen të na dëmtojnë”, tha ai.

Vendimet e Samitit të Brukselit të NATO-s dhe agjenda e vitit 2030 përcaktuan një agjendë ambicioze për të siguruar që Aleanca është e përgatitur për t'u përballur me këto sfida, shtoi ai. Duke pritur Samitin e Madridit të vitit 2022, aleatët variojnë nga forcimi i qëndrimit pengues dhe mbrojtës, deri te rritja e elasticitetit kombëtar dhe kolektiv dhe investimi më shumë në teknologji inovative.

**Stabiliteti në BP kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe vëmendje të përhershme**

Në fjalën e tij Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană, në forumin To Be Secure (2BS), duke falenderuar Malin e Zi për organizimin e takimit To Be Safe (2BS) si “një ngjarje e madhe”, siç tha ai, uroi Malin e Zi “për festimin e 15 vjetëve të punës së përkushtuar në forcimin e demokracisë, sigurisë dhe stabilitetit në vend dhe rajonin më gjerë”. Mircea Geoană tha ndërkohë se puna e Malit të Zi është e çmuar dhe sidomos po aq të çmuara janë diskutimet që “zhvillohen në këtë Forum” edhe pse virtualisht. “Këtë vit në qershor, ne shënuam përvjetorin e katërt të anëtarësimit të Malit të Zi në NATO dhe ne ishim të nderuar të kishim Presidentin dhe Kryeministrin në Shtabin e NATO-s në muajt e fundit. Vendi juaj është një aleat i çmuar, duke dhënë kontribute të rëndësishme për sigurinë euroatlantike. Trupat malazezë ishin në Afganistan për më shumë se një dekadë. Ato janë të angazhuar në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë. Unë mirëpres që Mali i Zi po rrit shpenzimet e tij të mbrojtjes”, tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të NATO-s Mircea Geoana. “Këto kontribute na bëjnë të gjithëve më të fortë dhe më të sigurt dhe ato ndihmojnë në ndërtimin e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, një rajon që është me rëndësi strategjike për NATO-n.”, theksoi ai. “Paqja dhe stabiliteti i qëndrueshëm në këtë rajon kërkojnë përpjekjen tonë të vazhdueshme kolektive dhe vëmendjen e përhershme. Të gjitha vendet individuale mund të luajnë një rol për të ruajtur demokracinë dhe sundimin e ligjit, për të çuar përpara reformat e brendshme dhe për të arritur marrëdhënie të mira fqinjësore. Përparimi në të gjitha këto fronte është kyç për integrimin e plotë të kësaj pjese të rëndësishme të Evropës në familjen euroatlantike.”, tha ai. “Ju



mund të mbështeteni në NATO që ajo të vazhdojë të mbështesë aspiratat tuaja euroatlantike dhe t'ju ndihmojë të ecni drejt një të ardhmeje paqësore dhe prosperuese për të gjithë. Politikat tona në rajon, përfshirë politikën tonë me Dyer të Hapura, ndihmojnë në forcimin e stabilitetit dhe ndërtimin e bashkëpunimit më të madh në Ballkanin Perëndimor”, tha Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të NATO-s.

Duke nënvizuar rëndësinë e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, Mircea Geoana, theksoi rolin dhe rëndësinë e misionit të KFOR-it në Kosovë, si një “rol themelor” dhe përmendi situatën e ditëve të fundit në Veriun e Kosovës. “Stabiliteti ka qenë gjithashtu prioriteti i misionit tonë të KFOR-it në Kosovë për më shumë se 20 vjet tani dhe ne mbështesim me vendosmëri dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe përpjekjet e tjera që synojnë normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, si rruga e vetme përpara në arritjen e një marrëveshjeje të qëndrueshme politike dhe stabiliteti për të gjithë rajonin. Kohët e fundit, ne pamë se sa i rëndësishëm ka qenë ky dialog për të zvogëluar tensionet në Veri të Kosovës. Unë mirëpres marrëveshjet midis Beogradit dhe Prishtinës për të gjetur një rrugë përpara dhe inkurajoj të dyja palët që të qëndrojnë në rrjedhën e dialogut. Ekziston një bashkëpunim i shkëlqyer midis NATO-s dhe BE-së në

lidhje me Kosovën. Misioni ynë i KFOR-it po luan një rol themelor për të siguruar zbatimin efektiv të këtij aranzhimi në Veri të Kosovës, në përputhje me mandatin e tij në OKB.”, tha z. Geoana.

**Sfidat në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë**

“Në një shkallë më të gjerë, në këtë botë të paparashikueshme, ne duhet të punojmë së bashku dhe madje edhe më ngushtë se kurrë më parë. Si aleatë dhe me vendet dhe partnerët e tjerë që ndajnë vlerat tona, demokracinë, lirinë, sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut. Sa më shumë të bashkëpunojmë, aq më i mirë është shansi që kemi për të mbrojtur mënyrën tonë demokratike të jetesës kundër atyre që përpigjen të na dëmtojnë”. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm të NATO-s theksoi sfidat në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe jo vetëm. “Ne përballemi me shumë sfida. Konkurrenca strategjike po rritet. Rusia është më shtypëse në vend dhe më agresive jashtë vendit, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. Aktivitetet ushtarake dhe hibride të Moskës kanë për qëllim destabilizimin e shoqërive

tona, minimin e institucioneve tona dhe dobësimin e sistemeve tona demokratike dhe besimin e qytetarëve tanë në rrugën e ardhshme. Kina po përdor fuqinë e saj ekonomike dhe ushtarake për të kontrolluar njerëzit e saj, për të detyruar vendet e tjera dhe për të vendosur kontrollin mbi zinxhirët e furnizimit global, infrastrukturën kritike dhe asetet e tjera. përfshirë në rajonin tonë. Pekini po investon në porte, në hekurudha, në rrugë. Ai gjithashtu ka një prani në rritje të mediave në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe ndikon narrativën në avantazhin e saj. Ne gjithashtu përballemi me sulme kibernetike më të shpeshta dhe më të sofistikuar, kërcënime të vazhdueshme terroriste dhe natyrisht, ndikimet e sigurisë të ndryshimit të klimës”, tha z. Mircea Goeana. Të gjitha këto sfida, tha ai janë shumë më të mëdha sesa çdo vend mund të përballojë i vetëm. “Nuk ka mënyrë më të mirë për t'u bërë ballë atyre, sesa të qëndroni së bashku. Dhe kjo është ajo që ne bëjmë në NATO. Duke qëndruar së bashku të 30 aleatët në çdo sekondë, në një logjikë dhe qasje 360 gradë”.

Kur aleatët u takuan në Samitin e NATO-s në Bruksel në qershor, “udhëheqësit tanë vendosën të forcojnë NATO-n edhe më shumë. Ata ranë dakord për NATO 2030, një agjendë ambicioze për sigurinë tonë të ardhshme dhe transformimin e përhershëm të aleancës sonë të madhe.

Për të siguruar që së bashku, ne mbetemi gati për sfidat e së sotmes dhe ato të së nesërme.

Konkretisht, ne vazhdojmë të forcojmë parandalimin dhe mbrojtjen tonë në vend. Duke shpenzuar më shumë për mbrojtjen, duke investuar në aftësi të nivelit të lartë dhe duke rritur më tej gatishmërinë e forcave tona”, tha ai.

“Në të njëjtën kohë, si pjesë e NATO 2030, ne po forcojmë elasticitetin tonë, duke rritur mbrojtjen tonë kibernetike dhe

duke adresuar ndikimin e ndryshimit të klimës në sigurinë tonë. Ne po investojmë në teknologjitë më të fundit, për të mprehur avantazhin tonë teknologjik dhe për të ruajtur epërsinë tonë teknologjike. Së bashku, ne do të vazhdojmë të trajtojmë paqëndrueshmërinë, të luftojmë terrorizmin dhe të ruajmë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke rritur trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve për partnerët dhe duke thelluar marrëdhëniet tona me vendet e tjera, organizatat ndërkombëtare, sektorin privat dhe institucionet akademike”. Duke u ndalur në sektorin privat dhe institucionet akademike ai theksoi se “në këtë kontekst global, i cili po ndryshon, mënyra më e mirë për të ecur përpara është të sigurohemi që kjo treshe midis sektorit publik, qeverive tona, institucioneve tona shtetërore, sektorit tonë privat dhe akademisë sonë dhe shoqërisë civile të punojë më afër së bashku se kurrë më parë. Kjo është ajo që ne bëjmë në inovacion, kjo është mënyra për të bërë për t'u siguruar që Aleanca jonë të përshtatet me këtë mjedis shumë kompleks në të cilin po jetojmë”, tha ai. “Kjo është arsyeja pse Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, dhe unë vetë do të punojmë ngushtë me të gjithë aleatët ndërsa ne e çojmë këtë agjendë ambicioze përpara dhe përgatitemi për Samitin në Madrid në fund të qershorit 2022.” Z. Goeana tha se “Mali i Zi është një komb shumë mbështetës i NATO 2030”, dhe në përfundim të fjalës së tij tha se “kam besim se ju dhe të gjithë aleatët e tjerë, do të mbeteni të angazhuar në mënyrë aktive ndërsa ne i kthejmë vendimet e NATO 2030 në veprim. Ndërsa po fillojmë një proces konsultimi dhe negociatash për Konceptin e ri Strategjik, ndërsa ne po përgatisim Aleancën tonë të madhe, tani më shumë se shtatë dekada të vjetër, për të qëndruar të rinj dhe për të investuar në dekadën e ardhshme të kësaj Aleance tonë të veçantë.”

## Largohen nga Kosova të tjerë afganë që punuan me NATO-n, zhvendosen në vendet aleate

Shtatë qytetarë afganë mbërritën në Luksemburg për të filluar një jetë të re, më 12 tetor 2021. Më herët atë ditë, ata u larguan nga objektet e përkohshme në Kosovë, ku ishin akomoduar që nga evakuimi i tyre nga Kabuli në gusht dhe ku trupat nga Forcat e Përgjigjes të NATO-s kishin ndihmuar me strehim, kujdes dhe mbështetje, përmes selive individuale dhe familjare të jetesës, objektet e ngrënies, qendrat mjekësore dhe dentare, dhomat e takimeve, zonat rekreative për të rriturit dhe fëmijët dhe strehimet fetare. “Ne jemi mirënjohës ndaj përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës dhe personelit të Komandës së Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli dhe Task Force Noble për punën e madhe dhe koordinimin me autoritetet tona për të siguruar një proces të qetë për zhvendosjen e këtyre qytetarëve afganë në Luksemburg. Ne i mirëpresim ngrohtësisht dhe i mbësht-

tesim ndërsa fillojnë një jetë të re”, - tha znj. Natacha Gomes, e ngarkuara me punë a.i. në Ambasadën e Luksemburgut në Kosovë.

Falë përpjekjeve të përbashkëta të aleatëve, rreth 2,000 afganë që punuan me NATO-n dhe familjet e tyre, u evakuuan nga Kabuli në gusht, si pjesë



e misionit më të madh të evakuimit në historinë e NATO-s. NATO punoi gjatë gjithë kohës për të koordinuar evakuimet dhe përfaqësuesi i lartë civil i NATO-s, ambasadori Stefano Pontecorvo dhe stafi i tij luajtën një rol kyç në këtë drejtim. Gjatë dy javëve, më shumë se 120,000 njerëz u dërguan jashtë, në qindra fluturime aleate. Trupat nga SHBA, Britania e Madhe, Turqia dhe Norvegjia luajtën një rol kyç në sigurimin e aeroportit dhe funksionimin e një spitali në terren, ndërsa rreth 800 punonjës të NATO-s mbanin operacionet kryesore si furnizimi me karburant dhe komunikimet. Përpjekjet e përbashkëta vazhdojnë. Gjatë javëve të fundit, 80 ish-punonjës afganë dhe familjet e tyre u vendosën në Norvegji, më shumë se 100 në Mbretërinë e Bashkuar, rreth 100 në Gjermani dhe disa qindra të tjerë në vende të ndryshme aleate.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM PARAQET AGJENDËN

## Bruksel 21-22 tetor 2021: Takim i Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në një konferencë shtypi të datës 20 tetor 2021, prezantoi agjendën e takimeve të kësaj jave të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s. Takimi ministerial i Mbrojtjes do të mbahet në Bruksel në datat 21 dhe 22 tetor 2021.

“Ministrat do të marrin vendime për të forcuar sigurinë tonë kolektive dhe për të përcaktuar terrenin për Samitin e NATO-s në Madrid qershorin e ardhshëm”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në konferencën për mediet.

“Ata gjithashtu do të ndërmarrin hapa për

të ruajtur avantazhin teknologjik të Aleancës dhe do të vazhdojnë të vlerësojnë se si ne mund të forcojmë më tej parandalimin dhe mbrojtjen tonë. Për më tepër, ata do të diskutojnë Afganistanin me synimin për të siguruar që terroristët nuk mund ta përdorin Afganistanin si një strehë të sigurt. Ministrat do të takohen me partnerët e Aleancës, Finlandën dhe Suedinë, dhe Bashkimin Evropian, për të diskutuar se çfarë mund të bëjmë më shumë së bashku në një epokë të konkurrencës globale”, njoftoi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.



## “Steadfast Noon”

NATO filloi më 18 tetor 2021 stërvitjen e saj vjetore parandaluese, ku me dhjetëra avionë nga e gjithë Aleanca, do të praktikojnë mbrojtjen e aleatëve evropianë të NATO-s. Ushtrimi njëjavor, i quajtur “Steadfast Noon”, po zhvillohet në Evropën jugore dhe përfshin avionë dhe personel nga 14 vende të NATO-s.

Stërvitja është një aktivitet trajnimi rutinë, i përsëritur dhe nuk lidhet me asnjë ngjarje aktuale botërore. Ajo pritet nga një vend i ndryshëm i NATO-s çdo vit. “Steadfast Noon” përfshin fluturime stërvitore me avionë luftarakë me aftësi të dyfishta, si dhe avionë konvencionalë, të mbështetur nga avionët e mbikëqyrjes dhe karburantit. Asnjë armë e luftarake nuk përdoret. Ky ushtrim ndihmon për të siguruar që parandaluesi bërthamor i NATO-s të mbetet i sigurt, i mbrojtur dhe efektiv.

Në Samitin e NATO-s në qershor, krerët e shteteve dhe qeverive aleate deklaruan se “qëllimi themelor i aftësisë bërthamore të NATO-s është të ruajë paqen, të parandalojë shtrëngimin, si dhe të parandalojë agresionin”. Ata gjithashtu deklaruan se “duke pasur parasysh mjedisin e përqësuar të sigurisë në Evropë, një Aleancë bërthamore e besueshme dhe e bashkuar është thelbësore”. Në të njëjtën kohë, udhëheqësit aleatë theksuan se “NATO ka një histori të gjatë për të bërë pjesën e saj në çarmatimin dhe mos-përhapjen. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, NATO reduktoi në mënyrë dramatike numrin e armëve bërthamore të stacionuara në Evropë dhe mbështetjen e saj në armët bërthamore në strategjinë e NATO-s.”

### Daniela Morgante riemërohet Kryetare e IBAN

Këshilli i Atlantikut të Veriut rizgjodhi znj. Daniela Morgante, Anëtare e Bordit Italian, si Kryetare e IBAN me një afat nga 1 nëntori 2021 deri në fund të mandatit të saj më 31 korrik 2023.

Znj. Morgante është gjyqtare në Institucionin Suprem Italian të Auditit dhe Këshilli fillimisht e emëroi atë si Anëtare të Bordit të IBAN më 01 gusht 2019 për një mandat katërvjeçar. Ajo ka shërbyer si Kryetare e IBAN që nga 1 nëntori 2019.

Në rolin e saj si Kryetare e IBAN, znj. Morgante është përgjegjëse për organizimin, planifikimin dhe shpërndarjen e punës së IBAN midis Anëtarëve të Bordit dhe stafit të auditimit për ekzekutimin e suksesshëm të mandatit të IBAN. Kryetari gjithashtu koordinon përfaqësimin e jashtëm të IBAN.

# NATO fillon stërvitjen vjetore parandaluese



## Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s viziton Islandën

Më 14 dhe 15 tetor 2021, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Robert Bauer, ishte në Islandë ku u takua me përfaqësuesit kryesorë islandezë, përfshirë Sekretarin e Përhershëm të Shtetit, z. Martin Eyjólfsson dhe drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë për Sigurinë dhe Mbrojtjes, znj. Bryndís Kjartansdóttir. Ai gjithashtu vizitoi Qendrën e Raportimit të Kontrollit të NATO-s, Keflavík (CRC) dhe Hangarin e Luftës Anti-Nëndetëse të NATO-s.

Kryetari i Komitetit Ushtarak, admiral Rob Bauer e filloi programin e tij zyrtar islandez duke vizituar Qendrën e Raportimit të Kontrollit të NATO-s Keflavík (CRC), ku u informua mbi rolin e saj në ofrimin e funksioneve të mbikëqyrjes ajrore të Aleancës. “Me pozicionin strategjik të Islandës, ka kuptim mbajtja e një syri në qiell dhe një në det. Ndërsa CRC luan një rol të rëndësishëm

për Misionin Islandez të Policimit Ajror, baza ajrore shërben si një qendër për operacionet ajrore dhe detare për NATO-n dhe SHBA-në”, tha admiral. Ai gjithashtu vizitoi Qendrën e Operacioneve Taktike Mobile USN (MTOC), Hangarin e Luftës Anti-Nëndetëse të NATO-s (ASW) dhe avionin amerikan P8.

Admirali u kthye në Reykjavik për t’u takuar me Sekretarin e Përhershëm të Shtetit, z. Martin Eyjólfsson dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë për Sigurinë dhe Mbrojtjes (Shef i Mbrojtjes), znj. Bryndís Kjartansdóttir. Diskutimet u përqëndruan për sigurinë në Arktik dhe Veriun e Lartë, si dhe rëndësinë e mbrojtjes së linjave detare të komunikimit dhe monitorimin e hapësirës Groenlandë-Islandë-Mbretëri e Bashkuar.

Pas takimeve me një përfaqësues nga Komisioneri Kombëtar i Policisë islandeze, ku admiral

Bauer në një takim të shkurtër u informua për rolin e rëndësishëm të luajtur nga gatishmëria civile dhe shërbimet e urgjencës civile, ai vizitoi vullnetarët e Ekipit të Shpëtimit Tokësor Ajror të Reykjavik. Admirali vuri në dukje se “Islanda është një vend me bukuri të madhe, por me mot drastik dhe të qenit i papërgatitur mund ta ndryshojë atë. Kjo është arsyeja pse një përgjigje e shpejtë dhe efikase është zgjidhja e vetme në disa situata. Puna e bërë nga Rojet Bregdetare islandeze, Policia Kombëtare dhe Ekipi i Shpëtimit Tokësor Ajror ndihmon në shpëtimin e jetëve”. Kryetari e përfundoi vizitën e tij me takimin me Njáll Trausti Friðbertsson, Zëvendëskryetari i parë i Komitetit të Punëve të Jashtme të Alpingi dhe Kryetar i delegacionit islandez në Asambleenë Parlamentare të NATO-s

### Italia pret Forumin NATO-Industri 2021

Forumi NATO-Industri është vendi kryesor për dialog strategjik me industrinë mbi planifikimin, zhvillimin dhe realizimin e aftësive të NATO-s, i sponsorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, Forumi është i bashkë-organizuar nga Komandanti Suprem i Aleancës për Transformimin, gjenerali Philippe Lavigne dhe Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Investimet në Mbrojtje, Camille Grand.

Këtë vit Forumi ofron një mundësi për udhëheqësit e industrisë që të kontribuojnë në debatin mbi zhvillimin e Konceptit të ri Strategjik të NATO-s, i cili do të miratohet në Samitin e 2022 në Madrid.

Dita e parë e Forumit do të fillojë duke eksploruar zgjidhje praktike për të përmirësuar gatishmërinë e blerjes së sistemeve të reja nga NATO, e ndjekur nga vlerësimi i ndikimit të Teknologjive Ndërrprerëse në Zhvillim në Aleancë dhe seanca plenare mbi sfidat dhe mundësitë e rrjetëzimit (networking cloud), inteligjencës artificiale dhe sistemet me funksione autonome.

Sesionet plenare në ditën e dytë do të bëjnë vlerësime strategjike të peizazhit të mbrojtjes dhe sigurisë, duke parashikuar aftësitë që do të kenë nevojë për forcat tona të mbrojtjes në dekadën e ardhshme, duke përfunduar me rekomandime se si të përmirësohet qëndrueshmëria e NATO-s në mjedisin aktual gjeopolitik të sigurisë.

Forumi NATO-Industri do të përfshijë kontribute nga ambasadorët e NATO-s, Shefat e Mbrojtjes dhe Përfaqësuesit Ushtarakë, përfaqësues të lartë nga vendi pritës, Italia, institucionet e NATO-s dhe Evropës, Shefat Ekzekutivë dhe Vendimarrësit e Lartë që përfaqësojnë industrinë e mbrojtjes, sigurisë dhe tregtare, think-tanks dhe akademika.

Aktiviteti do të zhvillohet në 17-18 nëntor 2021, në Romë. Organizatorët dhe pritësit italianë të aktivitetit do të monitorojnë vazhdimisht situatën e COVID, në mënyrë që të sigurojnë kushtet e përshtatshme për pjesëmarrësit e NIF.

# Forcat Speciale ky aset kombëtar

## Heronjtë e heshtur për të cilët flet vetë historia



**B**atalioni i Forcave Speciale është krijuar me urdhër të Këshillit të Mbrojtjes Nr.2, datë 16 tetor 1998, ndërsa aktiviteti i shtabit të këtij reparti ka filluar në shkurt 1999 me katër Grupe Speciale. Batalioni i Forcave Speciale është njësi më speciale e FA shqiptare me qëllim realizimin e detyrave më të komplikuar, më të vështira dhe më të rrezikshme që mund t'i ngarkohen një njësie operacionale, ku përfshihen operacione speciale nga toka, ajri dhe deti.

Vendi i parë i dislokimit të njësisë ishte në rajonin e Farkës, meqënëse aty ndodheshin të dislokuar edhe helikopterët e Forcave Ajrore të cilët do të mundësonin përdorimin e këtyre forcave me shpejtësi dhe efikasitet të plotë.

Ndërsa nga marsi i vitit 2008, vend-dislokimi i Batalionit të Forcave Speciale është në garnizonin e Zall-Herrit (ish Regjimenti Komando), një terren i cili mundëson plotësimin e të gjithë nevojave të mbështetjes së stërvitjes së këtyre forcave.

Aktiviteti i këtij reparti daton prej 24 shkurtit të vitit 1999 dhe është i përbërë nga Shtabi dhe 4 grupe speciale. Komandanti i parë i Batalionit Special ka qënë Kolonel Hysen Ymeri një nga zbuluesit më të mirë të ushtrisë.

Më 3 gusht të vitit 1999 u morr në dorëzim flamuri luftarak i Batalionit.

Për realizimin e detyrave u fillua me përzgjedhjen e personelit i cili në fillimet e tij trajnohej nga instruktorë turq të Forcave Speciale. Me rritjen e kapaciteteve të këtij batalioni pas viteve 2007, kurset e FS filluan të realizoheshin nga vetë efektivet me cilësi të veçanta si durimi i kalit, precizion në qitje dhe saktësia taktike dhe teknike. Ky personel përzgjidhet nga të gjitha repartet e Forcave të Armatosura (FA), në bazë të dëshirës dhe vullnetit të tyre. Mbas përzgjedhjes, ky efektivi i nënshtrohet disa testeve të ndryshme 3-javore dhe kjo për të përfutur të drejtën për të vazhduar Kursin Bazë të Forcave Speciale, dhe vetëm ata që arrijnë të mbarojnë me sukses këtë kurs mund të bëhen pjesë e trupës të Forcave Speciale, dhe sipas specialitetit



dhe aftësive individuale ata bëhen pjesë e Kompanive të Antiterorit, Kompanisë Speciale Alpine, Parashutiste, Kompanisë së Zhytjes së Luftimit.

Prej krijimit të saj dhe në vazhdim njësitë e Forcave Speciale kanë realizuar detyra të ndryshme në bashkëpunim me FS e NATO-s si brenda dhe jashtë vendit. Ato kanë marrë pjesë në misione paqeruajtëse si në Bosnje-Hercegovinë, Afganistan, Irak, Çad, Kandahar etje.

Në të gjitha misionet FS Shqiptare kanë arritur suksese me përkushtim të plotë, duke sakrifikuar dhe jetën: në datën 20 shkurt të vitit 2012 ra në krye të detyrës Dëshmori i Atdheut, Kapiten Feti Vogli, komandant i grupit të parë special të Kompanisë së Zhytjes, në Daman të Afganistanit, dhe ku u plagos nëntetari Aleksandër Peçi.

Dërgimi për herë të parë i një anëtari të FS në Shtabin Qëndror të Forcave Speciale të NATO-s në Mons, Belgjikë si dhe krijimi i dokumentit strategjik për FS, në dhjetor të vitit 2011, me urdhër të MM dhe të SHSHP solli njohjen e Forcave

Speciale në komunitetin e FS të NATO-s dhe rritjen e kapaciteteve të saj.

Operacionet e para të BFS-së kanë filluar gjatë konfliktit të Kosovës në vitin 1999 si pjesë e monitorimit të kufirit.

Në vitin 2002 misionet e BFS kanë konsistuar në dhënien e ndihmës dhe largimin e banorëve nga zonat e përmytura, evakuimet e njerëzve, rruajtja e objekteve të rëndësishme të veçantë gjatë procesit zgjedhor, operacioni 6-mujor për kërkimin e viktimave të tragjedisë së 9 janarit të vitit 2004, përgjatë vijës bregdetare Vlorë-Himarë, lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës, armëve.

### Misionet Luftarake:

Për herë të parë që pas luftës së II Botërore në historinë e Forcave tona të Armatosura në korrik të vitit 2010 u nis nga BFS misioni i parë luftarak "EAGLE-1" në Kandahar të Afganistanit, në përbërje të Forcave të Ushtrisë Amerikane, për kërkimin dhe zbulimin e terroristëve që vepronin në atë zonë. Dhe më pas do vazhdon misionin e saj krahas ushtrive aleate të NATO-s.

### KOMANDANTËT NË VITE:

Kolonel Hysen Ymeri.  
Tetor 1998 – Janar 2001.  
N/Kolonel Xhevair Abdia.  
Janar 2001 – Janar 2002.  
N/Kolonel Bashkim Balla.  
Maj 2002 – Dhjetor 2005.  
Kolonel Ruzhdi Kuci.  
Dhjetor 2005 – Dhjetor 2006.  
Kolonel Dritan Demiraj.  
Janar 2007 – Nentor 2013.  
N/Kolonel Qazim Hoxha.  
Nentor 2013 – Dhjetor 2015.  
Kolonel Ekland Dauti.  
Janar 2015 – Korrik 2017.  
Kolonel Ilirjan Dauti.  
Korrik 2017 – Janar 2019.  
N/Kolonel Ramadan Karakushi.  
Janar 2019 – Maj 2020  
N/Kolonel Ajeta Jata  
Shtator-2020 dhe në vazhdim

### MISIONET PAQËRUAJTSE

Në gusht të vitit 2002 deri në shtator të vitit 2004 batalioni i Forcave Speciale ka marrë pjesë në 4 misione paqeruajtëse në Kabul të Afganistanit nën komandën e ISAF.

Nga viti 2002 dhe 2003 pjesëtarë të shtabit të batalionit (2 oficerë dhe 1 n/officer) kanë marrë pjesë në tre misione paqeruajtëse në Bosnje-Hercegovinë në shtabin e SFOR.

Nga viti 2005 deri në vitin 2008 çdo 6 muaj dërgon dy grupe speciale në mënyrë të rregullt që të kryejë detyra në Mosul (Irak).

Me detyra ngritje postbllloqesh, kontroll banesash arrestime terroristësh me forcat amerikane, shoqërimi personalitetesh të larta me eskorta të përforcuara.

Dhe me mbi 12 misione të kryera me sukses nga efektivi i Batalionit.

Në vitin 2008 ka marrë pjesë me një mision në Çad, me një grup në përbërje të forcave franceze.

Nga 26 prill të vitit 2017- Shkurt

2020 nga Batalioni i Forcave Speciale janë kryer 6 misione KFOR, Kosovë.

**Batalioni i Forcave Speciale nga 1 Mars 2021** funksionon me një shtab që kryen funksionet nga S-1 deri në S-7 dhe me 3 Kompani të Aksioneve Direkte (Speciale) të përbëra nga 4 Grupe Speciale me nga 12 efektive por edhe një minishtab kompanie.

Ky Ristrukturim ka pasur si qëllim mirëmenaxhimin dhe mirë alokimin e burimeve në mbështetje të Operacioneve speciale në përputhje me Misionin dhe detyrat e Regjimentit të Operacioneve Speciale, për të përmbytur misione të Operacioneve Speciale gjatë të gjithë spektrit të operacioneve Ushtarake në Kudër të NATO por edhe operacione në interes të Sigurisë Kombëtare.

Dinamika e shpejtë e zhvillimeve globale si dhe kërcënimet e reja Asimetrike dhe të karakterit "Hibrid" kërkojnë një përgjigje të përshtatshme me kërcënimet me forca të mirëtrajnuara, të ndërveprueshme si në spektrin Usharak por edhe me agjensitë e sigurisë për të identifikuar, parandaluar shkalëzimin, si dhe neutralizimin e kërcënimeve të ndryshme ndaj sigurisë.

Forcat e operacioneve Speciale janë "thembra e Akilit" në Operacionet aktuale të NATO-s, pasi ato vlerësojnë dhe i paraprijnë me përgjigje konkrete kërcënimeve dhe rrisqet e sigurisë.

**"Strategjitë pa taktikat janë rruga më e ngadaltë drejt fitores. Taktikat pa strategji janë zhurmë përpara humbjes".**

Operacionet speciale mund të kryhen në të gjitha fazat e spektrit të plotë të operacioneve, të cilat përfshijnë angazhimin e forcave gjatë kohës së luftës, në kohë paqeje dhe krizash, si dhe dhe në mbështetje të/ose pjesëmarrje në Operacionet Ndërkombëtare të Stabilitetit.

Misionet e Operacioneve Speciale të zhvilluara brenda vendit duhet janë të specifikuar dhe të autorizuar në legjislativin e Republikës së Shqipërisë për përdorimin e Forcave të Armatosura. Doktrina e Forcave Speciale e miratuar në dhjetor 2017 përcakton principet themelore nëpërmjet të cilave Forcat e Operacioneve Speciale zhvillojnë operacione për arritjen e objektivave strategjike dhe përmbyshjen e synimeve politiko-ushtarake.

Në ditën e tyre të krijimit 23 vite më parë Forcat Speciale do merrnin mesazhe urimi, mirënjohjeje dhe falënderimi dhe nga Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Prof. Asoc. Bajram Begaj, si dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji.

**Gjeneralmajor Begaj** në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni vlerësoi përkushtimin, ndjenjën e lartë të përgjegjësisë që kjo njësi ka treguar ndër vite, duke përfaqësuar vlerat më të mira të Forcave tona të Armatosura, në operacionet brenda e jashtë vendit krahas aleatëve të NATO dhe part-





nerëve të tjerë.  
“Mirënjohje të përhershme për kapiten Feti Voglin, ushtarakun që u bë kurora e krenarisë duke i dhënë njësisë tuaj statusin e batalionit të heronjve. Kjo njësi nuk do të ishte këtu sot, pa ndihmën e partnerëve tanë strategjikë dhe në mënyrë të veçantë SHBA, të cilët kanë rritur dhe përmirësuar kapacitetet operacionale luftarake, falë mbështetjes me instruktorë të Forcave Speciale në fushën e trajnimit të shtabit dhe trupave para dislokimit në zonat e rrezikut, si dhe në operacionet luftarake në Afganistan...” – u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij.  
**Gjeneral brigade Arben Kingji** në fjalën përshëndetëse do shprehej:  
“Bereta vishnje është një simbol

marrë vlerësimet më të larta nga partnerët tanë ndërkombëtar.  
Suksese të mëtijshme në rrugëtimin tuaj në realizimin me sukses të çdo misioni që do t’ju ngarkohet në të ardhmen.”  
Gëzuar dhe ju uroj shëndet dhe mbarësi për ju dhe familjet tuaja!  
Komandanti i Njesisë Speciale Ajet Jata në fjalën e tij përshëndetëse do ishte falenderues për realizimin e detyrave nga ana e Forcave Speciale si dhe mirënjohjen për përkrahjen në këtë rrugëtim të vështirë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, si dhe Komandantit të Forcës Tokësore.  
**I nderuar Zoti Shef I Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Major Prof. Asoc. Bajram Begaj;**



ekselence dhe kurajoje, ndaj gjej rastin që në emër të Komandës së Forcës Tokësore të shpreh urimet më të përzemërta për të gjithë efektivet të këtij batalioni.  
Përgjatë gjithë këtyre viteve, Forcat Speciale kanë krijuar imazhin më pozitiv të Forcave të Armatosura të RSH, duke treguar kurdoherë profesionistin elitare dhe të sakrificës që nuk kanë kursyer as gjakun dhe as mundin për të justifikuar emrin e tyre dhe përmirësuar imazhin e vendit dhe FARSH.  
Ky 23-vjetor ju gjen me një historik të pasur angazhimesh në zonat luftarake dhe bashkëpunimesh brenda dhe jashtë vendit me partnerët tanë të NATO-s, ku të gjithë ju pjestarë aktual dhe ‘ish-specialsa’, keni demonstruar një nivel të lartë përgatitje e profesionalizmi duke

I nderuar Zoti Komandant I Forcës Tokësore Gjeneral Brigade Kingji, Komandant i ROS, Kol. Zani,  
Të nderuar, ish komandantë, të ftuar dhe pjesëtarë të Forcave Speciale.  
Shumë faleminderit për praninë Tuaj në këtë ditë të shënuar për Batalionin e Forcave Speciale. 23 vite më parë me vendimin e veçantë të Kryetarit të Këshillit Mbrojtjes (Zotit Rexhep Meidani) Nr 02 Datë 16.10. 1998 u krijuan për herë të parë Forcat Speciale Shqiptare.  
Vendimarrja për krijimin e Forcave Speciale lidhet me situatën në veri të vendit si rezultat i luftës që zhvillohej në Kosovë, me nevojën e pasjes së një force elitare dhe të aftë për të kryer detyra speciale me spektër të plotë.  
Po ashtu lidhet me reflektimin ndaj një koncepti operacional të munguar në

hierarkinë e forcave luftuese, ku Forcat Speciale janë njësi dhe instrumenti më fleksibël dhe më i dobishëm i sigurisë kombëtare, ku nëpërmjet detyrave taktike japin impakte strategjike.  
Krijimi i Forcave Speciale nuk erdhi vetëm si nevojë e domosdoshme e një aseti kombëtar të munguar, por edhe e punës, përkushtimit dhe vullnetit të jashtëzakonshëm të të gjithë pjestarëve të parë me në krye N/Kol Hysen Ymeri i cili arriti të hedhë bazat e krijimit të Forcave Speciale dhe të fomësojë këtë njësi, ku stërvitja dhe profesionalizmi ishin tipari kryesor dallues nga pjesa tjetër e ushtrisë.  
Përgjatë këtij rrugëtimi 23 vjeçar sfidues por edhe frytëdhënës, kanë ndodhur transformime të mëdha në kuadrin e formimit operacional të FS si modernizimi në paisje, përshtatja në koncepte, pjesmarrje në operacione të shumta speciale, përshtatja e taktikave dhe teknikave të reja, teknika të fituar së fundmi nga eksperiencia nëpër misionet dhe trajnime me Forcat Speciale të ushtrive të vendeve anëtare të NATO-s, si dhe krijimin e një koncepti të qartë për të ardhmen, na bëjnë të ndihemi krenar për të gjitha arritjet e kësaj njësie. Në këtë rrugëtim pa kthim, kjo njësi ka treguar integritet, disiplinë, kurajo, vetmohim dhe trimëri në përmbushje të misionit dhe të detyrave të ngarkuara brenda dhe jashtë vendit duke i dhënë vendit tonë dëshmorin e parë të atdheut nga radhët e batalionit të forcave speciale Kapiten Feti Voglin, ku sakrifica, devotshmëria dhe vetmohimi i tij në përmushje të misionit dhe detyrave të ngarkuara është një shembull i skalitur në mendjet dhe zemrat e cdo pjestari të FS  
Sot pas më shumë se dy dekadave, kjo njësi është më e konsoliduar, me më shumë eksperiencë dhe më e ndërveprueshme, kjo falë punës së palodhur të cdo pjestari ndër vite të FS por edhe e mbështetjes së pakursyer nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi I Përgjithshëm, Komanda e FT dhe së fundmi ROS.  
Të nderuar pjesëmarrës !  
Rrugëtimi i FS nuk do ndalojë sot, përkundrazi, na presin sfida akoma më të mëdha, ne duhet të ecim përkrah FS të NATO-s dhe si të tilla duhet të përmbushim angazhimet e marra duke krijuar një Task Grup Tokësor të FS të gatshme për t’u dislokuar në kuadër të NATO-s, por edhe vijimin e punës për krijimin e kapaciteteve tona kombëtare përtej angazhimeve ndaj aleancës, ku synojmë që Forcat Speciale të jenë të afta të kryejnë detyra në të gjithë spektrin e plotë të operacioneve



ushtarake, në mëvetësi apo me forcat konvencionale.  
Si komandant i kësaj njësie, me bindje të plotë ju them se Forcat Speciale nuk janë vetëm imazhi i forcës, kapaciteteve dhe aftësive speciale, por janë edhe një aset kombëtar, janë

(Ajet Jata)”  
Zoti Shef I Shtabit të Përgjithshëm, Zoti Komandant I Forcës Tokësore !  
Më lejoni t’ju shpreh në emër të të gjithë efektivit të FS mirënjohjen time të thellë për praninë tuaj sot këtu dhe për mbështetjen e pakursyer të dhënë



zgjidhje dhe jo zgjedhje, njësi shumë e vlefshme që zotërojnë aftësi dhe eksperiencë operacionale, e nëse përdoren në mënyrën e duhur ato sjellin benefite të mëdha për vendin dhe kombin dhe nëse përdoren jo në mënyrën e duhur ka humbje të aftësive dhe të eksperiencës


nga ana JUAJ për Batalionin Special.  
Duke shfrytëzuar këtë ditë feste, unë ju siguroj se do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim e profesionalizëm duke garantuar përmushjen e misionit dhe të detyrave si dhe duke lartësuar emrin e batalionit të forcave speciale.



së tyre. Ndaj me plot siguri them :  
“Nëse mjekët janë diagnostifikuesit më të mirë të sëmundjeve në shëndetin e njeriut, FS janë diagnostifikuesit më të mirë të sigurisë në ditët e sotme”

Për efektivin e batalionit të Forcave Speciale, Gëzuar 23 vjetorin e krijimit, shëndet, suksese dhe çdo të mirë në familje, punë dhe kudo.

**Punoi  
Anjeza Musollari**



“Tani jemi në fazën e dytë të planit të koordinuar dhe të përbashkët sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tani jemi në fazën që kapacitetet ushtarake po rriten përditë, nevojat shtetërore kërkohen. Në këto rrethana ka qenë edhe vizita, por edhe koordinimi i përbashkët”.



## Vizita në Uashington

# Mehaj: Aty ku ka nevojë Amerika, aty do të jetë edhe ushtria e Kosovës krah për krah me ta

**Z**oti Mehaj ishte këto ditë për një vizitë në Uashington, gjatë të cilës u takua me zyrtarë të lartë amerikanë, përfshirë Nënsekretarin amerikan të Mbrojtjes Colin Kahl.

Ministri Mehaj tha se takimet me zyrtarë të lartë amerikanë ishin në kuadër të kontakteve të rregullta dypalëshe në shërbim të thellimit të bashkëpunimit drejt krijimit të ushtrisë së Kosovës dhe kapaciteteve të saj.

“Kosova është në formim e sipër të ushtrisë së saj. Këtë dëshirë ka populli ynë për qindra e mijëra vite. Sot jemi në atë nivel që bashkë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës po krijojmë kapacitetet që i duhen shtetit të Kosovës”, tha për Zërin e Amerikës Ministri Mehaj.

Në vjeshtën e vitit 2018, Kosova me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, vendosi që përmes ndryshimeve ligjore të bëjë transformimin e Forcës së Sigurisë në ushtri.

“Tani jemi në fazën e dytë të planit të koordinuar dhe të përbashkët sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tani jemi në fazën që kapacitetet ushtarake po rriten përditë, nevojat shtetërore kërkohen. Në këto rrethana ka qenë edhe vizita, por edhe koordinimi i përbashkët. Siç e dini, kohët e fundit kemi pasur një stërvitje të përbashkët ushtarake, një prej stërvitjeve më të mëdha ushtarake. Ishim edhe vend mikëpritës për herë të parë në Kosovë. Tani po bashkëpunojmë për stërvitjen ‘Defender Europe 23’, por edhe për operacione të përbashkëta ndërkombëtare. Aty ku ka nevojë Amerika, aty do të jetë edhe ushtria e Kosovës krah për krah me ta”, tha ministri Mehaj.

Zoti Mehaj thotë se siguria dhe ekonomia janë përparësi të qeverisë së Kosovës, duke shtuar se vitin që vjen mundësitë e investimeve në sektorin e sigurisë do të jenë më të mëdha pasi është parashikuar një rritje prej 40 për qind e buxhetit për ushtrinë.

Zoti Mehaj thotë se Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-së po punon për blerjen e pajisjeve ushtarake për ngritjen e kapaciteteve ushtarake të forcave të armatosura, siç janë dronët për të cilët po diskutohet me palën amerikane.

“Po kemi diskutuar, këto janë në proces, jo vetëm dronat por edhe bler-



je të tjera. Jemi në koordinim e sipër për mënyrën se si do të funksionalizohen”.

Zoti Mehaj tha se përparësi e punës

së tij është edhe përfshirja e më shumë grave dhe pjesëtarëve nga komunitetet në FSK. Por, sfida mbetet përfshirja

e pjesëtarëve të komunitetit serb, për shkak të trysnisë së ushtruar nga Beogradi.

“Kemi kaluar në disa vështirësi si shtet edhe si ushtri e Kosovës për shkak të kërcënimeve që vijnë tek komuniteti serb, që të mos jenë pjesë e niveleve të sigurisë shtetërore të Kosovës. Aty kemi humbur një numër të madh pjesëtarësh. Tani jemi në rekrutim e sipër. Kemi koordinim me shumë pjesëtarë që janë në ushtri të Kosovës dhe që janë nga komuniteti serb. Ata janë të kënaqur. Por edhe e ndiejnë veten shpesh të kërcënuar, sidomos pjesëtarët që janë nga pjesa veriore e Kosovës”.

Gjatë qëndrimit në Uashington Ministri i Mbrojtjes u takua edhe me Drejtoreshën e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Robin Brook dhe Zv. Ndhmës Sekretarin e Shtetit për Evropën Jugore dhe Qendrore, Gabriel Escobar.

## Osmani: Prioriteti i Kosovës anëtarësimi në BE

**P**residentja e Kosovës, Vjosa Osmani, teksa ka pranuar Raportin e Progresit – të përpiluar nga Komisioni Evropian – për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, në një takim që ka pasur me shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë Tomas Szunyog, ka thënë se shteti që ajo udhëheq, e ka prioritet anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe se askush nuk mund të ndalë vendosmërinë e institucioneve të Kosovës për sundim të ligjit dhe për të mbrojtur integritetin e institucioneve.

Ajo e ka mirëpritur rikonfirmimin e mbështetjes së Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, dhe ka thënë se liberalizimi është proces qenësor për ruajtjen e kredibilitetit të BE-së në raport me zbatimin e politikës së zgjerimit.

Raportin e ka pranuar edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Kryeministri Kurti ka konsideruar se në gjashtëmujorin e dytë, Kosova ka shënuar shumë përparim, periudhë kur ka nisur udhëheqjen Qeveria e tij.

“Në këta gjashtë muaj të Qeverisë, kemi stabilitet institucional, legjitimitet demokratik dhe besueshmëri të lartë në institucione nga ana e qytetarëve, që përbën progres të madh shoqëror, që do ta kishin zili, jo vetëm e rajonit, por edhe jo pak vende të Bashkimit Evropian”, është mësuar të jetë shprehur Kurti. Ky raport përfshin gjetjet për të gjitha vendet që synojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Në raportin e këtij viti është parë përparim i kufizuar i vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë drejt përmbushjes së kritereve për integrim në Bashkimin Evropian.

Dokumenti është prezantuar nga Komisioneri evropian për Zgjerimin, Oliver Varhelyi.

Gjatë prezantimit, Komisioneri Varhelyi ka thënë se politika e BE-së për zgjerimin është interes strategjik i bllokut evropian për paqen, stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik.


Raportet janë hartuar për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë) si dhe Turqinë. Në raportin e këtij viti është thënë se Kosova duhet të angazho-

het në mënyrë konstruktive dhe të bëjë përpjekje të tjera substanciale në “zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të kaluara” të arritura në kuadër të dialogut me Serbinë dhe të “kontribuojë në arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë”. Sipas raportit, jostabiliteti politik dhe pandemia kanë ndikuar në përparim të kufizuar sa i përket axhendës së reformave evropiane të Kosovës.

Aty është përmendur edhe jostabiliteti politik në Kosovë, më konkretisht “atmosfera polarizuese politike”.

Komisioni Evropian, megjithatë ka thënë se Kosova ka bërë përparim në luftën kundër terrorizmit, “veçanërisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre”.

Megjithatë, Komisioni Evropian ka pasur kritikë për sistemin gjyqësor, pasi sipas tij, administrimi i drejtësisë vlerësohet se vazhdon të jetë “i ngadalshëm, joefikas dhe i ndjeshëm ndaj ndikimeve politike”. Si pikë pozitive është parë Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Planin e Veprimt, që është miratuar në gusht të vitit 2021.



Shekerinska falënderoi përfaqësuesit e shteteve anëtare për të gjithë ndihmën ndër vite drejt anëtarësimit të plotë dhe tha se Maqedonia e Veriut e vlerëson dhe nuk e harron këtë. Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës për Diplomacinë Publike Baiba Brazhe theksoi se ekspozita ilustron një rrugë të mbushur me angazhim dhe mençuri. “Ju jeni një histori suksesi,” tha Brazhe.



## “Rruga e Maqedonisë së Veriut drejt NATO-s”

Në selinë e Aleancës së NATO-s në Bruksel, ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska hapi më 20 tetor ekspozitën me titull “Rruga e Maqedonisë së Veriut drejt NATO-s”.

“Kam kënaqësinë të hap këtë ekspozitë e cila përfaqëson rrugën tonë drejt Aleancës. Momenti i anëtarësimit në NATO ishte një moment për t’u mbajtur mend, një moment krenarie. “Ne patëm sukses sepse ishim të përkushtuar dhe sepse kishim mbështetjen tuaj,” tha ministrja në hapje para ambasadorëve të NATO-s.

Shekerinska falënderoi përfaqësuesit e shteteve anëtare për të gjithë ndihmën ndër vite drejt anëtarësimit të plotë dhe tha se Maqedonia e Veriut e vlerëson dhe nuk e harron këtë.

Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës për Diplomacinë Publike Baiba Brazhe theksoi se ekspozita ilustron një rrugë të mbushur me angazhim dhe mençuri. “Ju jeni një histori suksesi,” tha Brazhe. Në ekspozitë janë paraqitur 28 fotografi të njerëzve dhe ngjarjeve që shënuan rrugën e vendit tonë drejt NATO-s, në periudhën nga viti 1993 deri në vitin 2021. Pas ekspozitës, në ambientet e Delegacionit të Përhershëm të Maqedonisë së Veriut në Aleancë, ministrja Shekerinska falënderoi shumë njerëz që brenda NATO-s mbështetën dhe ndihmuan fuqishëm integrimin e vendit tonë në Aleancë ndër vite.

# Ministrja Shekerinska: Ne ia dolëm sepse ishim të përkushtuar dhe patëm mbështetjen tuaj



## Ministrja Shekerinska hapi turneun perkujtimor në futboll të vogël për mbrojtësit e rënë

Turneu Qendror Përkujtimor në futboll të vogël në nder të mbrojtësve të rënë u hap këtë mëngjes në qendrën sportive “Boris Trajkovski”, ku u drejtuan ministrat e Mbrojtjes dhe të Brendshme Radmilla Shekerinska dhe Oliver Spasovski.

“Turneu përkujtimor është mënyra jonë çdo vit për të përkujtuar në mënyrë aktive mbrojtësit e rënë, për t’i falënderuar ata dhe për të shprehur ngushëllimet tona për familjet e secilit anëtar të forcave të armatosura që dhanë jetën në shërbim,” tha ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska e cila hapi turneun e këtij viti.

Shekerinska theksoi se motivimi dhe angazhimi i përfaqësuesve të Shoqatës së Mbrojtësve – Heronjtë e Maqedonisë, për të organizuar këtë turne në futboll të mbyllur, tregon më së miri respekt për guximin e mbrojtësve tanë, bijve tuaj, burrave tuaj, baballarëve, heronjve tanë.

Ajo shtoi se pjesëtarët e Armatës, Policisë, të gjitha shërbimeve të sigurisë, së bashku me zjarrfikësit, stafin mjekësor dhe të gjithë të tjerët që janë pjesë e një sistemi të tillë janë njerëz që janë gjithmonë të gatshëm për t’i shërbyer qytetarëve të tyre dhe vendit të tyre.

“Është detyra e jonë të japim më të mirën dhe të krijojmë kushte që ata të bëjnë punën e tyre më mirë. Është detyra dhe detyrimi ynë të krijojmë mundësi të reja për prosperitet, zhvillim dhe përparim të tyre. Është detyra dhe detyrimi ynë ta japim atë maksimum çdo ditë, para tyre dhe në emër të së ardhmes së fëmijëve tanë,” tha Shekerinska.

Në fjalën e tij, ministri Spasovski theksoi: “Një nga vlerat që



na bashkon, na fisnikëron moralisht dhe njerëzisht – është tradita, në të cilën, ndër të tjera është thurur kujtesa kolektive e asaj që është e vrytytshme, domethënëse, ajo që është afër ne dhe e pavdekshme. Në këtë kontekst, kjo ngjarje sportive përkujtimore ka të njëjtin qëllim të lartë – të na mbledhë së bashku, të na kujtojë vazhdimisht të gjithë kolegët dhe miqtë tanë të dashur, personazhet dhe veprat e tyre sublime në emër të lirisë së vendit tonë dhe qytetarëve të tij.

Spasovski shtoi se me respekt të thellë për të gjithë pjesëtarët tanë

të rënë në institucionet e sigurisë, por edhe për të dashurit e tyre, humbja e të cilëve është e pariparueshme, ne dërgojmë një mesazh të fortë dhe të rëndësishëm: “Ne kurrë nuk duhet të harrojmë atë që u detyrohemi heronjve, që ne kemi një detyrim të qartë që vazhdimisht synojmë për më mirë, për njerëzit, duke shfrytëzuar sa më mirë mundësitë që na janë dhënë, pa dyshim, falë mbrojtësve tanë.”

Në ngjarjen e sotme folën gjithashtu edhe kryetari i Shoqatës “Heronjtë e Maqedonisë” Vlado Stojanovski dhe sekretari i përgjithshëm i Sindikatës së Policisë Maqedonase, Kiro Trajkovski. “Ata, si pjesëtarë të forcave të sigurisë, mbrojtën atdheun e tyre, duke mbrojtur sovranitetin dhe integritetin, duke dhënë me fisnikëri jetën e tyre për të jetuar në liri dhe paqe. Heronjtë tanë me veprat e tyre do të kujtohen gjithmonë dhe do të jetojnë përgjithmonë në ndërgjegjen kolektive të popullit maqedonas. “Nëse mund të flasim nga përjetësia, do t’ju themi se heronjtë nuk vdesin, humbja e tyre ndihet, jo vetëm në familje por edhe në forcat e sigurisë”, tha në fjalën e tij kryetari i shoqatës, Vlado Stojanovski. Sekretari i Përgjithshëm i Sindikatës së Policisë Maqedonase, Kiro Trajkovski në emër të anëtarëve të sindikatës policore shprehu mirënjohjen për veprën heroike të kolegëve të rënë, e cila është shumë e vogël në krahasim me fisnikërinë e tyre që është themeli i të ardhmes së atdheut tonë. Ai shtoi se ata janë gjithmonë këtu sipas mundësive për t’u dalë në ndihmë familjarëve të mbrojtësve.

# Betimi Ushtarak sot në Republikën e Shqipërisë

## Betimi Ushtarak akti moral dhe ligjor, që bashkon kombet nën një gjuhë

**P**remtimi solemn i qytetarit që hyn në shërbimin ushtarak se do t'i qëndrojë besnik popullit e do të kryejë me nder detyrën ushtarake për mbrojtjen e atdheut pa u tërhequr para asnjë vështirësie dhe rreziku; akt, moral e ligjor. Betimi Ushtarak bëhet pasi janë marrë njohuritë e domosdoshme për shërbimin ushtarak. Ai kryhet në një mjedis festiv ku reparti është rreshtuar dhe në prani të përfaqësuesve më të lartë të shtetit, Presidentit (komandantit të forcave të armatosura), të veteranëve, të prindërve e të afërmeve të dëshmorëve. Me rastin e betimit ushtarak mbahen fjalime, bëhen parakalime etj.

### “Betimi” i Mbretit Zog me Përkrenaren e Skënderbeut

Betimi ushtarak në të gjitha kohërat ka qënë ai që ka bërë” kokat” më të mëdha të udhëheqësve të mos merrnin bekimin e fronit, nëse nuk do të përkuleshin para tij si para zotit.

Shtypi britanik i kohës jep një detaj tepër interesant. Mbreti Zog u kërkoj autoriteteve austriake të sillnin Përkrenaren e Skënderbeut në Shqipëri me rastin e kurorëzimit të tij. Austriakët refuzuan të nxjerrin nga muzeu përkrenaren e heroit të shqiptarëve, por i dërguan një kopje Mbretit të Shqiptarëve. Nuk dihet ç'ndodhi me atë kopje sepse ajo nuk u ekspozua. Për të, ndoshta, lajmi do të ishte kurorëzimi me Përkrenaren e Skënderbeut por lajm botëror u kthye betimi i tij i veçantë me dorën mbi Kuran dhe Bibël.

Betimi ushtarak është vazhdim i traditës së besëlidhjes, i dhënies së fjalës në kuvende popullore ose para luftëtarëve të çetave për liri, i besnikërisë së partizanëve të Luftës ANÇ. Betimi ushtarak u bë në mënyrë solemnë për herë të parë më 10 korrik 1946. Formula e betimit ushtarak në vitet 1980 : “Si shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe si pjesëtar i Forcave të Armatosura të RSH betohem se do të jem kurdoherë luftëtar i denjë, besnik dhe i papërkulur deri në fund, i gatshëm në çdo çast që të mos kursej as jetën time për mbrojtjen e interesave të larta të popullit e të atdheut”.

### Çfarë është betimi ushtarak?

Betimi ushtarak bëhet nga një qytetar i shtetit shqiptar, i cili ka hyrë për herë të parë në shërbimin ushtarak, ose një qytetar që nuk ka kryer shërbimin ushtarak dhe është thirrur për stërvitje ushtarake për herë të parë. Betimi ushtarak është një dokument me rëndësi të madhe shtetërore që ka fuqinë e ligjit.

Me mbërritjen e një ushtari në vendin e parë të shërbimit ushtarak pas përfundimit të fillimit trajnimit ushtarak, betimi bëhet në një atmosferë solemnë, me Flamurin Shtetëror të Shtetit Shqiptar dhe Flamurin e Njësisë Ushtarake. Personeli ushtarak i



“Betimi” i Mbretit Zog me Përkrenaren e Skënderbeut



Betimi Ushtarak sot në Republikën e Shqipërisë

cili është betuar në Betimin Ushtarak është në radhët e para.

Pas interpretimit të Himnit Kombëtar bëhet betimi sipas formulës së mëposhtme:

“Betohem se do t'i shërbej me besnikëri Republikës së Shqipërisë; do të jem ushtar besnik i popullit tim, luftëtar i denjë, trim e i disiplinuar, do të jem i gatshëm në çdo kohë e vend dhe nuk do të kursej as jetën time për mbrojtjen e interesave të atdheut. Betohem!”.

**Histori:** Historia e betimit ushtarak daton në shekullin e 9 -të. Përmendja e parë e këtij zakoni daton në këtë shekull. Betimet e para ushtarake të njohura për ne u bënë në një atmosferë solemnë. Pas pagëzimit të Rusisë, lindi një traditë, e cila erdhi nga Bizanti, për të ftuar një klerik që të betohej. Ndërsa shqiptonte tekstin e betimit ushtarak, luftëtari puthi kryqin. Në periudhën e drejtimit të Nën Pjetrit I, rituali filloi të kryhej duke përfshirë flamurin. Në të njëjtën kohë,

një regjiment i tërë do të jepte betimin ushtarak. Atmosfera në betimin ushtarak ishte solemnë. Aty morën pjesë autoritete të larta, klerikë.

Federata Ruse ishte ajo që do i jepte një rëndësi mjaft të madhe Betimit Ushtarak, duke e mitizuar si betimin mbi zot.

Betimi ushtarak i Federatës Ruse jepej pranë monumenteve të lavdisë ushtarake. Gjithashtu, ky ritual solemn kryhej në vendet ku u zhvilluan beteja heroike për Atdheun. Teksti i betimit ka ndryshuar ndjeshëm ndër vite. Sidoqoftë, kuptimi i tij është i njëjtë me qindra vjet më parë. Procedura për dhënien e betimit ushtarak regjistrohet veçmas. Ky është një ritual i veçantë që zhvillohet gjatë formimit në terrenin e paradës. Në të

lexon tekstin e betimit ushtarak. Pastaj ai vendos nënshkrimin e tij në dokument, pastaj kthehet përsëri në shërbim.

Mbi kuptimin e betimit Besohet se fjalët e betimit përmbajnë një kuptim të thellë. Është e shkurtër, por, duke përmbushur detyrën e tij ushtarake, të marrë përsipër atë ditë, ushtari rishkruan faqet e biografisë së tij. Në fund të fundit, tani ai duhet të ndjekë me bindje udhëzimet e Atdheut. Ai kalon testet e pjekurisë së tij. Meqenëse teksti premton të mbështesë idealët e larta, çdo ushtar merr përgjegjësi të rëndësishme që nga momenti i betimit. Kuptimi kryesor i shërbimit të tij fshihet në to. Nga ai moment, ai zyrtarisht bëhet mbrojtësi i vendit të tij. Respektimi i përpiktë i fjalëve të thëna në këtë ditë është ligj për ushtarët. Largimi prej tij çon në çnderim. Për të mos përjetuar



Nga Betimi Ushtarak në periudha të ndryshme historike të Federatës Ruse



njëjtën kohë, të gjithë mbajnë veshur uniformë të plota, armët janë në duart e tyre. Një orkestër është e pranishme në terrenin e paradës, Flamuri i njësisë është në krye. Në rreshtin e parë janë ata që janë betuar. Para ritualit, komandanti i njësisë flet. Ai mban një fjalim se sa e rëndësishme është të bësh betimin ushtarak. Ndonjëherë ai personalisht u jep armë ushtarëve të rinj. Më tej, ushtari thirret jashtë veprimt dhe

pasoja të tij, ushtari ndjek me kujdes fjalën e dhënë. Që në ditët e para të shërbimit, ai respekton betimin ushtarak. Shkelja e detyrimeve, edhe në detajet më të vogla, çon në dëmtimin e gatishmërisë luftarake, interesave të vendit dhe të gjithëve që janë të dashur për ushtarin.

Punoi  
Anjeza Musollari

# Sfida e re e Epokës Covidiane: BE drejt rishikimit të rregullave të buxhetit

**B**ashkimi European kete jave filloi rishikimin e rregullave të tij për buxhetin e vendeve anëtare për t'iu përshtatur realitetit post-pandemik të një borxhi të lartë publik, shoqëruar me kostot e mëdha që sjell tranzicioni drejt një ekonomie me emetime zero të dioksidit të karbonit.

Gjatë këtij rishikimi historik që ka të ngjarë se do të zgjasë së paku deri në fund të 2022-it, qeveritarët, ekonomistët dhe akademikët do të diskutojnë rreth mënyrës sesi ata do të thjeshtëzojnë të ashtuquajturin Pakt i Stabilitetit dhe Rritjes, i cili ka marrë përmasa kaq të ndërlikuara, sa që pak njerëz arrijnë ta kuptojnë plotësisht atë.

Ajo çka nisi në 1997-ën si dy rregulla dhe një rezolutë prej 12 faqesh, është shumëfishuar që atëherë duke u shoqëruar nga një manual përdorimi 108 faqesh, i cili përditësohet çdo vit nga Komisioni European. Objektivi kryesor i Paktit është të mbrojë vlerën e euros, duke frenuar huamarrjen e qeverisë, sepse në një kohë kur Eurozona ka një politikë monetare të përbashkët në mbështetje të monedhës së saj, secili prej 19 vendeve anëtare vendos vetë për politikën e tij buxhetore. Pikërisht ky fakt ka qenë burimi i shumë fërkimeve ndër vite. Në 2002-in, presidenti asokohe i Komisionit European, Romano Prodi e quajti Paktin “budalla”, pohim të cilit ai i qëndron ende sot e kësaj dite.

“Ky pohim më shkaktoi shumë probleme në atë kohë, por më vonë shumë njerëz më dhanë të drejtë sepse ata e panë sesi Pakti nuk funksionoi në periudha të vështira” – tha Prodi për Reuters.

“Unë nuk mendoj se e kam pasur gabim”.

Rreziku për të drejtuar politikën fiskale kombëtare me një monedhë të përbashkët doli në pah në vitin 2010, kur huamarrja e tepërt e Greqisë, e kryer fshehtazi nga statistikat e BE-së dhe rregullat e Komisionit, shkaktoi krizën e borxhit sovran që gati sa nuk e shkatërroi monedhën e përbashkët. Pakti ka ndryshuar tri herë deri më tani: në 2005-ën kur Franca dhe Gjermania nuk pranorin të zbatonin vetë rregullat, në 2011-ën dhe në 2013-ën gjatë krizës së borxhit, me qëllim për t'i garantuar tregjeve se investimet në euro ishin të sigurta.

Ndryshimet e pritshme për t'u debatuar tanimë janë po ashtu rrjedhojë e një krize, këtë herë të shkakuar nga pandemia e Covid-19, e cila ka rritur borxhin mesatar në vendet e Eurozonës në afro 100% të prodhimit kombëtar, nga 60-70% që ishte në fillim të viteve '90, kur u hartuan rregullat.

Reduktimet vjetore të borxhit

referuar rregullave aktuale janë thjesht jo realiste për vende të cilat borxhi ka prekur pragun e 160% të PBB-së si Italia dhe mbi 200% si Greqia.

“Ruajtja e borxhit në nivelin 60% kishte kuptim kur Traktati i Maastricht\*-

it u negociua, por tanimë nuk ka asnjë kuptim” – tha Klaus Reging, kreu i fondit të shpëtimit të eurozonës, njëherësh ish-drejtuari i departamentit ekonomik të Komisionit European.

“Aftësitë kredimarrëse të qeverive

janë më të mëdha sot nga sa kanë qenë në kohën kur është negociuar Traktati i Maastricht-it. Ndaj ekzistojnë elementë që duhet të rishikohen” – shtoi më tej Regling. Por, teksa shumica e ministrave të financave besojnë se kufizimet që çojnë

drejt reduktimit të borxhit janë shumë të rrepta për botën post-pandemike që po jetojmë, nuk ka ende një marrëveshje nëse ato mund të trajtohen përmes kuadrit ligjor aktual apo përmes ndryshimeve të vështira në tekstet ligjore.

Një sfidë tjetër e madhe është të sigurohet se rregullat nuk do të lidhin duart e qeverive të 27 vendeve anëtare të BE-së për të vënë në lëvizje me qindra miliarda euro në funksion të emetimeve zero të CO2 deri në vitin 2050-të. Në analizën e një grupi ekspertësh të kontraktuar për llogari të ministrave të financave të Bllokut u evidentua se investimet publike shtesë, për të përbushur qëllimet e BE-së për klimën, do të duhet të jenë 0.5% – 1.0% të PBB-së vjetore vetëm për këtë dekadë.

Ekspertët propozuan përjashtimin e investimeve për të luftuar ndryshimet klimatike nga përllogaritja e deficitit të BE-së. Ndërkohë që kjo ide gëzon mbështetjen e përgjithshme të Spanjës, Francës dhe vendeve të tjera, disa zyrtarë nxjerrin në pah vështirësitë që kanë ndeshur në përcaktimin e asaj çka nuk konsiderohet “një investim i gjelbër”. Zëvendës Presidenti i Komisionit Valdis Dombrovskis u shpreh se ideja e përjashtimit të investimeve për frenimin e ndryshimeve klimatike do të jetë padyshim pjesë e diskutimit të ardhshëm./ Reuters

\* Traktati i Maastrichtit njihet më shumë si Traktati i Bashkimit European, pasi me të, nisi rruga që do të çonte në vitin 2002 në hyrjen në qarkullim të monedhës së përbashkët europiane, Euro.





# Batalioni II i Këmbësorisë zhvillon me sukses stërvitjen “Luani 21-01” dhe “Kobra 21-01”

Në zbatim të plan - kalendarit të stërvitjeve të Forcës Tokësore për vitin 2021, Batalioni II i Këmbësorisë i Forcës Tokësore zhvilluan stërvitjet e radhës “Luani 21-01” dhe “Kobra 21-01” në periudhën 18-21 tetor 2021.

Stërvitja “Luani 21-01” dhe “Kobra 21-01” kishin në fokus gadishmërinë dhe stërvitjen, e cila u ekzekutua me dhënien e sinjalit të kushtrimit ku u vlerësuan koha e paraqitjes në detyrë të efektivit, tërheqja e armatimit, pajimeve dhe pajisjeve luftarake sipas TOP-it, planëzimi i shtabit të b2k, rreshtimi i mjeteve organike si dhe raportimi për gadishmërinë për lëvizje në rajonin e dislokimit në Rreth-Greth, Rrogozhinë.

Kjo stërvitje shërbeu për të përmirësuar gatishmërinë e nën reparteve dhe aftësinë drejtuese të tyre, në realizimin e provës së gadishmërisë dhe operacionit të luftimit mbrojtës. Nga i gjithë efektiv i pjesëmarrës në stërvitje pati angazhim dhe përkushtim maksimal.

